



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNA E ZVEÇANIT PËR VITIN 2021

Prishtinë, maj 2022

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komuna e Zveçanit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komuna e Zveçanit (Komuna e Zveçanit), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komuna e Zveçanit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

B1 Në vitin 2021, komuna ka dështuar të regjistrojë të gjitha pasuritë jofinanciare në regjistrin kontabël të pasurisë (SIMFK), pasuritë e paregjistruara janë: ndërtesat publike dhe toka. Kjo çështje është adresuar në auditimin e kaluar dhe janë dhënë rekomandimet e duhura, por asgjë nuk është ndërmarrë lidhur me këtë, udhëheqja komunale ka deklaruar arsyet dhe problemet në regjistrimin e pasurisë dhe arsyet tjera administrative. Rrjedhimisht, pasuritë e prezantuara në PVF-të e komunës për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021, nuk janë paraqitur drejtë dhe saktë. Gjithashtu, komuna ende nuk ka filluar regjistrimin e e-pasurisë nën 1,000€ dhe nuk i ka shpalosur ato në PVF.

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komuna e Zveçanit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Komuna e Zveçanit ka vazhduar edhe në vitin 2021 me pagesat e energjisë elektrike nga kategoria ekonomike subvencionet dhe transferet, që për nga natyra i takojnë kategorisë për shërbime komunale. Gjithsej janë bërë shtatë (7) pagesa në vlerë prej 6,668€.
- A2 Më 19 janar 2021, Komuna e Zveçanit ka nënshkruar kontratën për ofrimin e shërbimeve të telefonisë mobile, e cila është lidhur për një periudhë 36 mujore, me një çmim total prej 29,412€. Kontrata është nënshkruar duke anashkaluar procedurat e prokurimit. Gjatë viti 2021 janë kryer gjithsej 12 pagesa në vlerë prej 11,627€. Përveç nënshkrimit të kontratës pa procedura të prokurimit, komuna nuk ka rregullore të brendshme për shpenzimet e telefonisë mobile.
- B2 Komuna ende nuk mbledh të hyra nga taksat e pronës dhe lejet e ndërtimit dhe nuk ka miratuar rregullore të brendshme për tatimet, tarifrat, taksat dhe ngarkesat për ofrimin e shërbimeve publike për qytetarët.

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komuna e Zveçanit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komuna e Zveçanit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komuna e Zveçanit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komuna e Zveçanit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komuna e Zveçanit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit kemi vërejtur se sistemi i kontrollit të brendshëm në Komunën e Zveçanit në disa fusha nuk është në nivelin e duhur. Fushat për përmirësime të mundshme janë: korrigjimi i nevojshëm i informacioneve financiare të paraqitura në pasqyrat financiare vjetore, mbledhja e të hyrave nga tatimi në pronë dhe lejet e ndërtimit, regjistrimi i të gjithë pronës komunale (ndërtesat publike, toka) në regjistrat kontabël të SIMFK-së, si dhe regjistrimi i pasurisë jokapitale nën 1,000€ në e-pasuri, zbatimin e kontratave përmes procedurave të prokurimit si dhe ofrimin e shërbimeve të auditimit të brendshëm NjAB - të. Të njëjtat, janë paraqitur më poshtë për t'u shqyrtuar në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve dhe kërkojnë veprim prioritarë, për të parandaluar dëmtimin e mëtejshëm të buxhetit komunal.

Ky raport ka rezultuar me dhjetë (10) rekomandime, nga të cilat katër (4) janë rekomandime të reja, pesë (5) janë përsëritur dhe një (1) është përsëritur pjesërisht.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Regjistri jo i saktë i pasurisë dhe shpalesje jo të sakta në PVF

Gjetja	<p>Rregullorja e MF - nr. 02/2013, neni 6, për menaxhimin e pasurive jofinanciare në organizatat buxhetore kërkon që secila organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe përditësojë një regjistrë të pasurive jofinanciare që menaxhon. Regjistri duhet të mbahet veçmas për çdo pasuri dhe në formë të përmbledhur sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël. Rregullorja po ashtu specifikon se pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo-kapitale duhet të regjistrohet në e-pasuri.</p> <p>Në vitin 2021, komuna ka dështuar të regjistrojë të gjitha pasuritë jofinanciare në regjistrin kontabël të pasurisë (SIMFK), pasuritë e paregjistruara janë: ndërtesat publike dhe toka. Kjo çështje është adresuar në auditimin e kaluar dhe janë dhënë rekomandimet e duhura, por asgjë nuk është ndërmarrë për këtë, komuna ka theksuar arsyet dhe problemet në regjistrimin e pronës dhe arsyet tjera administrative. Rrjedhimisht, pasuritë e prezantuara në PVF-të e komunës për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 nuk janë paraqitur saktë. Po ashtu, komuna ende nuk ka filluar regjistrimin e e-pasurisë nën 1,000€ dhe nuk i ka shpaleshur ato në PVF.</p> <p>Shkaku sipas zyrtarëve komunal qëndron në faktin se, Komuna e Zveçanit, është relativisht e re në sistemin e Kosovës, është një nga ato komuna të paraprirë nga administrata e UNMIK-ut, dhe se asnjëherë nuk ka ndodhë deri tek pranim-dorëzimi i pronës së trashëguar. Komuna e Zveçanit nuk ka burime të mjaftueshme njerëzore dhe ekspertë të cilët mund të vlerësojnë dhe të regjistrojnë pronën e trashëguar.</p>
Ndikimi	<p>Mos regjistrimi i të gjithë pronave e bën të vështirë për komunën menaxhimin dhe shfrytëzimin e suksesshëm të pronës për të marrë vendime racionale që do të ishin në interes të të gjithë qytetarëve. Gjithashtu, të dhënat dhe informatat jo të plota në regjistrin e pasurisë rezultojnë me paraqitje të pasaktë në PVF.</p>
Rekomandimi B1	<p>Kryetari, duhet të ndërmerr masa për të siguruar se pasuritë mbi dhe nën 1,000€ janë regjistruar në regjistrat përkatës, për të gjitha pasuritë që ka në posedim, në mënyrë që prezantimi i informatave në PVF të jetë i saktë dhe i plotë. Njëherësh duhet të siguroj që është vënë në përdorim sistemi e-pasuria.</p>

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Keq-klasifikimi i shpenzimeve

Gjetja Sipas nenit 18, pika 3 e rregullores 01/2013 - MF për Shpenzimin e Parasë Publike, shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Në planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Komuna e Zveçanit ka vazhduar ti kryej pagesat e energjisë elektrike nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve, që për nga natyra i takojnë kategorisë së shërbimeve komunale. Janë bërë gjithsej shtatë (7) pagesa në vlerë prej 6,668€. Në raportin e auditimit të vitit 2020 kjo çështje është trajtuar si Theksim i Çështjes, me qëllim që komuna të ketë vëmendjen për përmirësim.

Shkaku kryesor i këtij problemi qëndron në mungesën e kontrollit të brendshëm adekuat që synon të përcaktojë problemin dhe t'i tregojë menaxhmentit nevojën për eliminimin e menjëhershëm të parregullsive.

Ndikimi Pagesat e bëra nga një kategori joadekuate ndikojnë negativisht në klasifikimin e shpenzimeve në Pasqyrat Financiare të Komunës dhe si të tilla ofrojnë informata të pasakta për përdoruesit e PVF-ve.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë të ndërmerren të gjitha veprimet për të siguruar që shpenzimet të planifikohen në ndarjet apo rialokimet e duhura buxhetore dhe që pagesat dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhen në përputhje me kodet përkatëse ekonomike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Anashkalimi i procedurës së prokurimit

Gjetja Neni 4 i Rregullores Financiare nr. 01/2013/MF për shpenzimin e parasë publike, ndër të tjera parashikon se - Prokurimi është një element i rëndësishëm për shpenzimin e parasë publike, ndërsa Neni 21 përcakton shpenzimet që nuk kërkojnë procedurë prokurimi, përkatësisht: pagat, shpenzimet e paguara me para të vogla, avanset për udhëtimet zyrtare, shërbimet komunale, subvencionet dhe transferet dhe transaksionet ndër-sektorale.

Më 19 janar 2021, Komuna e Zveçanit ka nënshkruar kontratën për ofrimin e shërbimeve të telefonisë mobile, e cila është lidhur për një periudhë 36 mujore, me një çmim total prej 29,412€. Kontrata është nënshkruar duke anashkaluar procedurat e prokurimit. Gjatë viti 2021 janë kryer gjithsej 12 pagesa në vlerë prej 11,627€. Përveç nënshkrimit të kontratës pa procedura të prokurimit, komuna nuk ka rregullore të brendshme për shpenzimet e telefonisë mobile.

Mangësia e lartpërmendur ka ardhur si pasojë e funksionimit të dobët të kontrolleve të brendshme.

Ndikimi Moszbatimi i procedurave të prokurimit ul transparencën e shpenzimeve të parasë publike, dhe për shkakë të mos konkurrencës, mund të krijojë shpenzime shtesë dhe të pa kontrolluara.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë do të rishikojë bazën ligjore të kontratës dhe se për të gjitha shpenzimet që kërkojnë procedura të prokurimit në përputhje me rregullat, do të veprojnë në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurim Publik dhe LMFPP.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Mos zbatimi i ligjit për mbledhjen e të hyrave (Te hyrat nga tatimit ne pronë)

Gjetja Neni 2 i ligjit nr. 06/L-005 për tatimin në pasuri të paluajtshme thotë qartë se çdo organizatë buxhetore duhet të mbledhë të hyrat nga tatimi në pronë. Gjithashtu, Ligji nr. 04/L-110 për ndërtim, Neni 1 dhe 2 përcakton qëllimin e dhënies së lejeve të ndërtimit.

Komuna ende nuk mbledh të hyra nga taksat e pronës dhe lejet e ndërtimit dhe nuk ka miratuar rregullore të brendshme për tatimet, tarifrat, taksat dhe ngarkesat për ofrimin e shërbimeve publike për qytetarët.

Kjo ka ndodhur për shkak se komuna ende nuk ka vendosur politika për zbatimin e ligjit dhe nuk ka ndërmarrë veprime konkrete për mbledhjen e të hyrave nga këto aktivitete që kanë një ndikim të rëndësishëm në nivelin e buxhetit komunal.

Ndikimi Moszbatimi i ligjeve dhe rregulloreve për mbledhjen e tatimit në pronë, lejeve të ndërtimit, tarifave dhe tatimeve tjera nga ana e Komunës reflekton një qasje joserioze ndaj zbatimit të kërkesave ligjore në këtë fushë, dhe zvogëlon nivelin e të ardhurave dhe mundësinë e financimit të projekteve nga ky burim të ardhurash.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë zbatimin e Ligjeve për mbledhjen e të hyrave, të cilat kanë për qëllim zbatimin e kërkesave ligjore dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunës. Në të njëjtën kohë, Kryetari duhet të fillojë menjëherë iniciimin për hartimin e një rregulloreje të brendshme për tatimet, tarifrat dhe taksat e qytetarëve për shërbimet komunale.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Kontrollat e brendshme në raportimin financiar

Çështja A3 - Dobësitë në përgatitjen e PVF-ve

Gjetja

Rregullorja e MF-së nr. 01/2017 për raportimin financiar vjetor të Organizatës Buxhetore, dhe Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik “Raportimi Financiar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme.

Në Pasqyrat Vjetore Financiare kemi identifikuar gabimet e mëposhtme:

- Neni 13. Raporti mbi pranimin dhe pagesën në para të gatshme - Shpenzimet në vlerë prej 6,000€ financimi nga huamarrja, janë paraqitur si të hyra tjera;
- Neni 14. Raporti i Ekzekutimit të Buxhetit, hyrja e parë në kolonën e buxhetit përfundimtar, Shënimi nr. 11 sipas SIMFK - të hyrat nga donacionet nuk janë paraqitur në vlerë prej 14,456€;
- Neni 14.6 Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe përfundimtare buxhetore - në kategorinë e hyrjes së ndarjeve në grante të caktuara të donatorëve sipas SIMFK - nuk është paraqitur shuma prej 14,456€. Po ashtu, në kategorinë e alokimeve dalëse, nuk kishte dallim në mes buxhetit fillestar dhe buxhetit final, si burim i financimit të të hyrave vetanake të transferuara nga vitet e kaluara sipas SIMFK në vlerë prej 26,000€ në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve;
- Shënimi 5. Subvencionet dhe transferet, buxheti final është paraqitur në vlerë prej 85,000€, sipas SIMFK është në vlerë prej 124,000€;
- Shënimi 10. Të hyrat e dedikuara - janë paraqitur të hyrat nga gjobat e policisë rrugore në vlerë prej 29,000€, të cilat nuk është dashur të paraqiten në këtë shënim; dhe
- Shënimi 13. Pagesat nga palët e treta janë paraqitur në vlerë prej 14,400 €, sipas SIMFK nuk është dashur të paraqiten fare.

Përgatitja e PVF-ve nga Komuna nuk ishte bërë në përputhje me kërkesat e Rregullores nr. 01/2017 për raportim financiar. Pas identifikimit të gabimeve dhe këshillave tona, Komuna ka marrë masa (përveç çështjeve të opinionit i auditimit) dhe ka bërë korrigjimet e nevojshme dhe versioni i korrigjuar i PVF është përgatitur në përputhje me kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik “Raportimi Financiar Bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme”, dhe përmbushin të gjitha detyrimet raportuese që dalin nga Korniza Ligjore për raportimin.

Përgatitja e PVF-ve për komunën është mjaftë sfiduese. Çështjet e shumta për korigjimin e tyre, siç janë listuar më lartë, tregojnë se sistemi i kontrollit të brendshëm mbetet në nivelin jo të duhur.

Ndikimi

Paraqitja e pasaktë dhe jo e plotë e informatave financiare dhe jo financiare në PVF-të, ka ndikuar në pa saktësi të të dhënave dhe ulë shkallën e besueshmërisë së shfrytëzuesit të synuar.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të shtojë kontrollet gjatë përgatitjes së PVF-ve në mënyrë që shpalosjet në PVF për vitin 2022 të mos përmbajnë gabime kontabël dhe administrative. Deklarata e lëshuar nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Financiar nuk duhet të nënshkruhet nëse nuk janë kryer të gjitha kontrollet e nevojshme sipas draft PVF-ve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final në kategorinë paga dhe mëditje është 1,298,006.24€, ndërsa shpenzimet ishin 1,277,699.33€, është shpenzuar 98.44%. Numri i të punësuarve në buxhetin fillestar/të planifikuar për vitin 2021 është 368, numri i të punësuarve në fund të vitit ishte 246 punëtorë, prej të cilëve 25 janë deputetë të Kuvendit Komunal.

Çështja C1 - Mungesa e dëshmive për vijueshmëri në punë

Gjetja Sipas Nenit 8 të Rregullores 12/2020 për orarin e punës dhe pushimet e nëpunësve publikë, “Të gjithë nëpunësit publikë janë të detyruar të jenë në punë gjatë orarit të punës. Çdo nëpunës publik regjistrohet në librin e prezencës ose në regjistrin elektronik”.

Komuna ka filluar regjistrimin e ardhje/vajtjes së punëtorëve nga puna. Evidenca zbatohet që nga qershori i vitit 2021 dhe mbahet nga zyra e burimeve njerëzore. Mirëpo, Komuna nuk ka një sistem elektronik për të mbajtur evidence për ardhje/vajtje në punë për punonjësit e saj, por përdor lista të cilat nënshkruhen nga punonjësit për ta dëshmuar prezencën në punë. Nga mostrat e audituara, në kemi identifikuar së në 22 raste, punonjësit nuk janë nënshkruar në listat e ardhje/vajtje në punë gjatë vitit 2021.

Komuna nuk ka një sistem elektronik për të mbajtur evidence për ardhje dhe vajtje në punë për punonjësit e saj, por përdor lista të cilat nënshkruhen nga punonjësit për ta dëshmuar prezencën në punë. Nga mostrat e audituara në kemi identifikuar së në 22 raste punonjësit nuk janë nënshkruar në listat e ardhjes- vajtje në punë gjatë vitit 2021.

Ndikimi Mungesa e dëshmive për praninë e këtyre punonjësve në punë, paraqet kontroll të dobët mbi menaxhimin e stafit dhe mundësinë e pagesave të parregullta ose fiktive për punonjësit që nuk respektojnë orarin e punës.

Rekomandimi C1 Kryetari duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar se zyrtarët nënshkruhen apo evidentohen në listën e vijueshmërisë apo regjistrin elektronikë, përndryshe kjo situatë paraqet shkelje disiplinore, në pamundësi të kontrollit të prezencës së këtyre zyrtarëve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe komunalitë ishte 333,265.93€, prej të cilave janë shpenzuar 247,164€ apo 74.16%. Këto shpenzime kanë të bëjnë kryesisht me karburante, mirëmbajtje dhe riparime, mobilje dhe pajisje, pajisje zyre nën 1,000€, shërbime të kontraktuara, etj.

Çështja B3 - Dobësi në menaxhimin e automjeteve zyrtare

- Gjetja** Sipas Udhëzimit Administrativ të MAPL-së nr. 2008/01 për përdorimin e automjeteve zyrtare në komuna, Neni 1 përcakton qëllimin e përdorimit të automjeteve, ndërsa Neni 2 përcakton të drejtën e përdorimit të automjeteve, duke plotësuar dokumentet e udhëtimit të përcaktuara nga njësia e transportit. Ndërsa sipas ligjit nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, Neni 12, Kuvendi i Komunës mund të miratojë akte nga kompetenca e tij.
- Shpenzimet e karburantit për vitin 2021 ishin në vlerë prej 15,748€. Komuna ka përgatitur një projekt-rregullore për përdorimin e veturave zyrtare, por Kuvendi Komunal (KK) ende nuk e ka shqyrtuar këtë rregullore. Sa i përket evidencës së shpenzimeve të derivateve, Komuna ka përgatitur raporte për shpenzimet mujore të derivateve sipas departamenteve, por ende nuk ka të dhëna të detajuara për çdo automjet individual (nuk ka urdhër udhëtimi, nuk ka raporte për shpenzimet e karburantit për kilometrat e kaluara).
- Shkak është bërë mungesa e kontrollit mbi zbatimin e rregullave të përcaktuara në udhëzimin administrativ.
- Ndikimi** Si rrjedhojë e kontrolleve jo efektive, janë paraqitur dobësitë në menaxhimin e automjeteve zyrtare në lidhje me mosplotësimin e urdhërave të udhëtimit dhe mosraportimin e të dhënave në lidhje me shpenzimet e krijuara që mund të ndikojnë në përdorimin joracional të tyre.
- Rekomandimi B3** Kryetari duhet të sigurojë që përdorimi i automjeteve dhe mbajtja e evidencave për përdorimin dhe shpenzime të karburantit të bëhet sipas kërkesave të UA, si dhe të aprovoj draft-rregulloren për përdorimin e automjeteve zyrtare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 124,348€, prej të cilave në vitin 2021 janë shpenzuar 98,477€ apo 79%. Këto shpenzime kanë të bëjnë me subvencione për subjekte jo publike në vlerë prej 95,977€, ndihmë financiare për të sapolindurit në komunën e Zveçanit, rehabilitim të objekteve dhe pronës nga fatkeqësitë natyrore, si dhe për subjekte publike në vlerë prej 2,500€.

Çështja A4 - Dobësi në subvencionimin e OJQ-ve

Gjetja

Rregullorja MF-nr. 04/2017 për kriteret, standardet dhe procedurat për financimin publik të organizatave joqeveritare, neni 12 Çdo mbështetje financiare e OJQ-ve duhet të publikohet në thirrje publike, sipas nenit 22 të së njëjtës rregullore ofruesi i mbështetjes financiare lidh një kontratë me shkrim me përfituesin e mbështetjes financiare. Gjithashtu, sipas nenit 23, pika 1 e së njëjtës rregullore, Monitorimi dhe raportimi për projektet dhe programet parashikon se “Për çdo kontratë të lidhur, mbështetësi financiar përcakton zyrtarin përgjegjës që duhet të monitorojë zbatimin e projektit”, ndërsa në pikën 2 thuhet se përfituesi është i detyruar të raportojë rregullisht tek zyrtari i monitorimit në lidhje me zbatimin e projektit/programit, në përputhje me kërkesat e kontratës.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, është vërtetuar se KZv.më 27 korrik 2021 ka transferuar mjete për financimin e OJQ-së Shoqata e Invalidëve në vlerë prej 2,000€ në bazë të vendimit të Kuvendit Komunal të miratuar më 26.05.2021. Mjetet janë transferuar pa shpallur thirrje publike, si dhe pa lidhur kontratë me përfituesin, me tutje OJQ-ja nuk ka dorëzuar raporte financiare dhe narrative kthyes.

Shkak për këtë është mungesa e kontrolleve të brendshme adekuate për respektimin e procedurave dhe monitorimin e procesit të subvencionimit.

Ndikimi

Ndarja jo transparente dhe e pakontrolluar e subvencioneve, pa monitorim të procesit të zbatimit dhe pa raportim, rritë rrezikun që mjetet buxhetore të ndahen dhe të shpenzohen në kundërshtim me qëllimet e komunës.

Rekomandimi A4

Kryetari duhet të ndermarr hapa në përputhje me Rregulloren për financimin publik të i OJQ-ve me thekse të veçantë në raportimin e përfituesve për shpenzimin e fondeve publike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Dobësi në monitorimin e subvencioneve

Gjetja

Sipas Nenit 8 dhe 9 të Rregullores për dhënien e subvencioneve komunale, i cili është miratuar në vitin 2015, janë përcaktuar kërkesat për miratimin e subvencioneve, të cilat duhet të përmbajnë dokumente që kanë të bëjnë me vërtetimin e vendbanimit të përhershëm në komunën e Zveçanit (fotokopje e letërnjoftimit ose vërtetim i autoritetit kompetent), një kërkesë me shpjegim të detajuar të nevojës për dhënien e subvencionit, dëshmitë që vërtetojnë qartë pretendimet në kërkesë.

Rregullorja komunale për subvencione, nuk përcakton kritere të qarta për monitorimin e subvencioneve nga komuna apo si do të vërtetonte se subvencionet e dhëna janë shpenzuar për një qëllim të caktuar. Megjithatë, vendimet e marra nga kryetari i komunës e detyrojnë shfrytëzuesin që brenda 30 ditëve të paraqesë një raport me dëshmi për shfrytëzimin e mjeteve.

Në asnjë nga pesë rastet e shqyrtuara nuk ka pasur raport nga përfituesi se si janë shpenzuar mjetet e pranuar.

Kjo situatë vjen si pasojë e mungesës së kontrolleve adekuate për vlerësimin dhe monitorimin e projekteve të subvencionuara.

Ndikimi

Dobësitë në procesin e monitorimit të zbatimit të subvencioneve, si dhe mospërcaktimi i qartë i kritereve në rregullore, mund të çojë në mos përmbushjen e qëllimit për të cilin synohet subvencionimi.

Rekomandimi B4

Kryetari duhet të sigurojë që Rregullorja për Subvencionet të përditësohet, si dhe të forcojë kontrollet për të siguruar monitorim efektiv të përdorimit të mjeteve të ndara nga buxheti komunal.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.5 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Nga organizatat buxhetore kërkohet që të sigurojnë që aktivitetet dhe proceset e tyre i nënshtrohen auditimit të brendshëm. Auditimi i brendshëm ndihmon organizatën të arrijë qëllimet e saj duke aplikuar një qasje sistematike dhe disiplinore për vlerësimin e biznesit përmes planifikimit të punës së auditimit duke identifikuar dhe vlerësuar natyrën dhe nivelin e rrezikut të lidhur me çdo aktivitet të organizatës.

Çështja B5 - Mungesa e krijimit të njësisë së auditimit të brendshëm

Gjetja

Ligji nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe Rregulloret QRK nr. 01/2019 për Themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit publik, Neni 4 dhe 5 përcaktojnë funksionin dhe mënyrën e themelimit të NJAB. Në bazë të Nenit 5. "Subjekti i sektorit publik i cili ka buxhet më pak se tre (3,000,000.00 €), funksionin e auditimit të brendshëm ta ushtron përmes mënyrave tjera sipas nënparagrafëve 1.2, 1.3. dhe 1,4 të nenit 4 të kësaj Rregulloreje (themelimi i njësisë së përbashkët ose marrëveshje për ofrimin e shërbimeve të auditimit nga një subjekt i sektorit publik ose kontraktimin e një shoqërie profesionale sipas kriterëve të përcaktuara, me miratimin paraprak të MF-së).

Komuna nuk është audituar gjatë vitit 2021, edhe pse ka dërguar kërkesë në MFPT për nevojat e shërbimit të auditimit të brendshëm, por nuk ka shfrytëzuar mënyra të tjera të kryerjes së funksionit të auditimit të brendshëm siç thuhet në Nenin 4 të Rregullores së QRK-së - nr. 01/2019 si: Njëpërmjet një marrëveshjeje për sigurimin e shërbimit të auditimit të brendshëm nga një subjekt i sektorit publik tek një tjetër subjekt me miratimin paraprak të Ministrit të Financave; apo Njëpërmjet kontraktimit të një kompanie profesionale për kryerjen e auditimit të brendshëm, pas aprovimit të Ministrisë së Financave.

Kjo është përsëritje vit pas viti, pasi që komuna nuk shprehë gadishmërinë që të vë në funksion aktivitetet e auditimit të brendshëm.

Ndikimi

Mungesa e raporteve të auditimit të brendshëm çon në përsëritje të vazhdueshme të dobësive në sistemet kryesore të kontrollit të brendshëm, dhe menaxhmenti mund të mos jetë në gjendje të identifikojë dobësitë e kontrollit dhe të përgjigjet në kohën e duhur për eliminimin e tyre.

Rekomandimi B5

Kryetari duhet të sigurojë se aktivitetet komunale i nënshtrohen auditimit të brendshëm, për të pranuar një vlerësim të pavarur të qeverisjes, menaxhimit të rrezikut dhe proceseve të kontrollit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Kemi shqyrtuar burimet e mjeteve buxhetore, shpenzimet nga kategoritë ekonomike dhe mbledhjen e të hyrave. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁴	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Burimet e fondeve	2,217,443	2,652,718	2,192,035	2,793,775	2,150,769
Grante Qeveritare - Buxheti	2,180,877	1,983,685	1,782,867	2,321,528	1,876,699
Financimi përmes huamarrjes	0	5,985	5,985	5,355	0
Fondi zhvillimor në mirëbesim	0	547,248	388,783	437,892	241,327
Të bartura nga viti i kaluar	0	25,848	0	27,600	26,393
Të hyrat vetanake	36,566	36,566	0	1,400	6,350
Donacionet e jashtme	0	53,385	14,400	0	0

Buxheti final në vitin 2021 është 2,652,718€, krahasuar me buxhetin fillestar të rritur për 435,275€. Diferenca mes buxhetit fillestar dhe atij final është rezultat i rritjes së të hyrave vetanake nga viti paraprak (25,848€), të hyrave nga donacionet e jashtme në vlerë prej (53,385€), transfereve nga Fondi i Zhvillimit (547,248€), financimi i kredisë (5,985€) dhe zvogëlimi i granteve Qeveritare për 197,192€.

Në vitin 2021, komuna ka shpenzuar 83% të buxhetit final ose 2,192,035€, që është një përmirësim prej 2% krahasuar me vitin 2020 (81%). Në realizimin e buxhetit kanë ndikuar shumë të hyrat nga Fondi Zhvillimor, të cilat në vitin 2021 janë transferuar në vlerë prej 547,248€, nga të cilat janë shpenzuar për realizimin e projekteve kapitale për infrastrukturën rrugore të komunës në vlerë prej 388,784€. Shpjegimet për pozicionin aktual janë paraqitur më në detaje më poshtë.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	2,217,443	2,652,718	2,192,035	2,793,775	2,150,769
Pagat dhe mëditjet	1,482,406	1,298,006	1,277,699	1,241,224	1,135,531
Mallrat dhe shërbimet	284,671	303,266	242,129	284,284	228,442
Komunalitë	30,000	30,000	5,035	4,925	6,045
Subvencionet dhe transferet	85,000	124,348	98,477	337,492	72,465
Investimet Kapitale	335,366	897,097	568,694	925,850	708,287

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë buxhetore janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final në kategorinë paga dhe mëditje është 1,298,006€, krahasuar me buxhetin fillestar është zvogëluar për 184,400€, është shpenzuar 98%, ndërsa nga totali i donacioneve të jashtme vlera prej 20,307€ nuk është shpenzuar.
 - Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe komunalitë është 333,266€, krahasuar me atë fillestar është rritur për 18,595€, janë shpenzuar 247,164.20€ ose 74%. Nga granti qeveritar janë shpenzuar 247,164€, nga të hyrat vetanake 36,566€ dhe nga donacionet e jashtme 18,594.93€ nga buxheti final kanë mbetur mjete të pashpenzuara në vlerë 61,137€. Realizimi i buxhetit final për mallra dhe shërbime krahasuar me vitin 2020 është ulur me 15%.
 - Buxheti final për subvencione ka qenë 124,348€, krahasuar me buxhetin fillestar është rritur për 39,348€, janë shpenzuar 98,477€ ose 79%. Buxheti final për subvencione është rritur për shumën e të hyrave vetanake të bartura nga viti 2020 për 25,848€ dhe granti Qeveritar për 13,500€. Realizimi i buxhetit final krahasuar me vitin 2020 është zvogëluar për 239,015€. Arsyeja e uljes është në buxhetin final, i cili ishte më i lartë në vitin 2020 për shkak të menaxhimit të pandemisë (COVID 19).
 - Buxheti final për investime kapitale është 897,097€, krahasuar me buxhetin fillestar të rritur për 561,731€, me mjete nga Fondi Zhvillimor në vlerë 547,248€ dhe donacioneve të jashtme në vlerë 14,483€. Janë realizuar 568,694€ ose 63% e buxhetit final, që është 39% më pak se në vitin paraprak 2020. Mjetet nga Fondi Zhvillimor Komunal janë realizuar në vlerë prej 388,783€ për këto punë infrastrukturore: “Rikonstruksioni dhe zgjerimi i rrjetit të kanalizimit në Zveçan”, “Ndërtimi i rezervuarit të ujit të pijshëm në Zveçan”, “Përgatitja e dokumentacionit projektues-technik - projektit kryesor dhe kryerja e shërbimeve të mbikëqyrjes së ekspertëve - kanalizimit” dhe “Kanalizimi - Punime shtesë për rikonstruksionin dhe zgjerimin e rrjetit të kanalizimit në Zveçan”.
- Si pasojë e situatës së pandemisë Covid-19, komuna ka shpenzuar 5,985€ euro për këtë qëllim. Miratimi i këtyre shpenzimeve është bërë nga kodi ekonomik (04) Financimi nga huamarrja, “Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike” i miratuar nga Qeveria në kuadër të Programit 00098 është shpenzuar në kategorinë e pagave dhe mëditjeve.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



Komuna për vitin 2021 ka inkasuar të hyra vetanake në vlerë prej 2,196€, që janë të hyra nga zyra e regjistrimit dhe qiraja, por ende nuk mbledh të hyra nga tatimi në pronë dhe leje ndërtimi.

Komuna gjithashtu ka inkasuar të hyra indirekte nga gjrobat e policisë në shumë prej 28,507€.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
Totali i të hyrave	36,566	36,566	2,196	2,293	1,762
Të hyrat jo tatimore	36,566	36,566	2,196	2,293	1,762

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Deri në fund të auditimit tonë të vitit 2021, tre (3) rekomandime janë zbatuar, pesë (5) ende nuk janë adresuar dhe një (1) është ende në proces, siç tregohet në grafikun 2 më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si ato adresohen, shihni Tabelën 4 (ose tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë zbatimin e ligjeve për mbledhjen e të hyrave, të cilat kanë për qëllim zbatimin e kërkesave ligjore dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunës. Në të njëjtën kohë, Kryetari duhet të fillojë menjëherë iniciimin për hartimin e një rregulloreje të brendshme për tatimet, tarifat dhe taksat e qytetarëve për shërbimet komunale.	Situata është e njëjtë si në vitin paraprak.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Të hyrat	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që të hyrat regjistrohen në kodet ekonomike përkatëse sipas Planit të kontabilitetit nga zyrtari i të hyrave.	Komuna mori masa dhe zbatoi rekomandimin e ZKA-së.	I zbatuar

3.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar se zyrtarët nënshkruhen apo evidentohen në listën e vijueshmërisë apo regjistrin elektronike përndryshe kjo situatë paraqet shkelje disiplinore, në pamundësi të kontrollit të prezencës së këtyre zyrtarëve.	Komuna ka marrë masat e nevojshme dhe që prej qershorit 2021 ka nisur regjistrimin e prezencës së punonjësve në punë. Mirëpo testet tona kanë identifikuar që jo të gjithë nënëpunësit evidentohen dhe nënshkruhen në listën vajtje ardhje në punë.	Pjesërisht i zbatuar
4.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari, duhet të siguroj se përfituesit gjatë realizimit të aktiviteteve/projekteve ju përmbahen kriteret të përcaktuara me kontratë. Kontrollat duhet të zbatohen në të gjitha fazat e realizimit të projektit me qëllim të arsyetimit të shpenzimit të parasë publike.	Komuna mori masa dhe zbatoi rekomandimin e ZKA-së.	I zbatuar
5.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari, duhet të siguroj që përdorimi i automjeteve dhe mbajtja e evidencave për përdorimin dhe shpenzime të karburantit të bëhet sipas kërkesave të UA, si dhe të aprovoj draft-rregulloren për përdorimin e automjeteve zyrtare.	Situata është e njëjtë si në vitin paraprak.	Nuk ka filluar zbatimin
6.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë zbatimin e plotë të rregullores së subvencioneve, si dhe mekanizmat për monitorimin dhe menaxhimin e subvencioneve. Kontrollat e subvencioneve duhet të forcohen për të siguruar monitorim efektiv të përdorimit të fondeve të ndara nga buxheti komunal.	Situata është e njëjtë si në vitin paraprak.	Nuk ka filluar zbatimin
7.	Pasuritë	Kryetari, duhet të ndërmerr masa për të siguruar se pasuritë mbi dhe nën 1,000€ janë regjistruar në regjistrat përkatës, për të gjitha pasuritë që ka në posedim në mënyrë që prezantimi i informatave në PFV të jetë i saktë dhe i plotë. Njëherit duhet të siguroj që është vënë në përdorim e-pasuria.	Situata është e njëjtë si në vitin paraprak.	Nuk ka filluar zbatimin
8.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të forcoj kontrollat lidhur me menaxhimin e dokumenteve/faturave të pranuar. Fillimisht, duhet të siguroj mbajtjen e një libri të protokollit, ku do të regjistrohen dhe protokollohen të gjitha faturat e pranuar.	Komuna mori masa dhe zbatoi rekomandimin e ZKA-së.	I zbatuar
9.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari duhet të sigurojë se aktivitetet komunale i nënshtrohen auditimit të brendshëm për të pranuar një vlerësim të pavarur të qeverisjes, menaxhimit të rrezikut dhe proceseve të kontrollit.	Situata është e njëjtë si në vitin paraprak.	Nuk ka filluar zbatimin

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Zukë Zuka, Ndhmës Auditor i Përgjithshëm



Blerim Kabashi, Drejtor i Auditimit



Nebojsa Ristić, Udhëheqës i ekipit



Stana Dancetović, Anëtare e ekipit



Hysen Restelica, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

OPŠTINA ZVEČAN KOMUNA E ZVEČANIT MUNICIPALITY OF ZVEČAN			
PRIMLJENO E PRANUAR 04.05.2022			
ORG. JED. ORB. DER. 646	No	PRILOG ANEKS	VREDNOST VLERA
17/22	17526		

KOMUNA E ZVEČANIT

ZVEČAN

Rr. Kralja Milutina pn.tel.(028)664-726, fax(028)664-728

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Zveçanit, për vitin 2021 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Dragisa Milovic
(Kryetar i Komunës Zveçani),



Data: 04/05/2022

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁵ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁶, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionin i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionin

Opinionin i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionin i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.